



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **61/2024. Ora: 11:00**

Data: **14.11.2024**

Vendi: **Zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së;

2. Raport i Këshillave të KQZ:

2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi e nominimeve për emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunën e Parteshit për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025;

2.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit dhe emërimit i anëtarit të KKZ në komunën e Lipjanit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025;

2.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për Doracak të trajnimit për Zgjedhjet e Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025 dhe për zgjedhjet lokale 2025;

2.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e distinktivëve për procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe për zgjedhjet lokale 2025;

2.1.5. Propozim për hapjen e kutive postare jashtë Kosovës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për ndryshim/ plotësimin e vendimit për planin e rekrutimit të KQZ dhe anulimi i procedurave të rekrutimit”;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së zëdhënësit të KQZ-së lidhur me shtesën për punë pa orar të paracaktuar;

5. Të ndryshme;

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari i KQZ, z. Radoniqi, e kryesoi mbledhjen dhe pasqyroi agjendën. Në fund, ai kërkoi që të hiqet pika e 3, ndërsa që mbetet pika për zëdhënësin...

(Nuk ka stenogram të incizuar për shkaqe teknike – ndërprerja e rrymës elektrike)

2. Raport i Këshillave të KQZ:

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1. Shqyrtimi dhe miratimi e nominimeve për emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunën e Parteshit për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani: Në KOZ, janë bërë shqyrtimet për emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunën e Parteshit. Ne, rekomandojmë KQZ-në për miratimin e këtyre dy anëtarëve: Aleksandra Maksimoviq të emërohet anëtare e KKZ-së në komunën e Parteshit nga OJQ "Sokrat". Bojana Bogdanoviq, të emërohet po ashtu, anëtare e KKZ-së. Është propozuar nga KKZ.

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit dhe emërimit i anëtarit të KKZ në komunën e Lipjanit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani: Gjithashtu, KOZ ka shqyrtuar edhe kërkesën e zëvendësimit dhe emërimit i anëtarit të KKZ në komunën e Lipjanit. Ne si KOZ, rekomandojmë që Ramadan Limani, i emëruar si anëtar i KKZ-së në komunën e Lipjanit nga subjekti politik PAI të zëvendësohet me kandidatin e propozuar Arsim Salihu i cili emërohet për anëtar e KKZ-së nga i njëjti subjekt politik.

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për shtypjen e distinktivëve për procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025 dhe për zgjedhjet lokale 2025:

Arianit Elshani: Gjithashtu, tha z. Elshani, janë shqyrtuar edhe specifikat teknike për shtypjen e distinktivëve për procesin e votimit. Anëtarët e KQZ me 10 vota për, miratuan edhe këtë rekomandim të KOZ-it.

3. Propozim për hapjen e kutive postare jashtë Kosovës.

Ilri Gashi: ...Ne, kemi qenë prezent ku do të bëhen Fahet postale, do të zbrazen ato! Nuk mund të kemi më shumë se një pikë në secilin shtet, pra vetëm një fah postal...

Ibrahim Selmanaj: Nëse kemi nevojë të hapim më shumë kutia, më shumë se 22...

Sami Hamiti: Nëse, nuk mund të hapen të gjitha, do ti orientojmë në tjera fahe postare. Ku ka pak votues, nuk hapen. Ne, jemi të përcaktohemi për 22, e taani shohim...Por, do ta informojmë mërgatën...

Gordana Llaban: Një pyetje: qytetarët e Kosovës që janë në Serbi si do të votojnë meqë, nuk kemi fah postar. A duhet të direkt me postë këtu te ne mund të votojnë, apo qysh...?

Alban Krasniqi: Meqë, ekzistojnë 3 forma votimi, një prej tyre është aplikimi për të votuar jashtë Kosovës por që e dërgon zarfin edhe në fahin postar në Prishtinë. Por, kur nuk mund të ketë tjera forma, mund ta përdorin dërgimin e zarfit me fletëvotim në fahun e republikës së Kosovës, apo në fahun në shtetin më të afërm...

Sami Hamiti: Me këtë, ky nuk është rasti i parë! Mos mundësia e hapjes së fahut në Serbi, nuk është faji jonë. Nuk ka një marrëveshje, dhe nuk zbatohet nga pala tjetër. Ka qenë më parë një pikë ndërlidhëse: Austria. Tash, e kanë të drejtën me dërgue në vendet fqinje në bazë të ligjeve dhe rregullave që kemi.

Sami Kurteshi: Drejtpërdrejtë nuk mund ta dërgojnë sepse, Serbia nuk e njuh postën e Kosovës mirëpo, vetëm përmes vendeve të treta...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 10 vota, miratohet.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së zëdhënësit të KQZ-së lidhur me shtesën për punë pa orar të paracaktuar:

Kreshnik Radoniqi: E kemi kërkesën e Valmirit. E kemi diskutua disa herë. Unë, si e dini, kamë qenë kundër, dikush për. Nuk jami i sigurve që e aprovojnë. Nëse e aprovojmë, ky nuk e ka më të drejtën e pjesës shtesë, e orëve shtesë...

A ka dikush diçka...? E kemi trajtue...! Kush është për...?

Me 9 vota, miratojet kjo kërkesë.

6. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi i ftesës

Kreshnik Radoniqi: Edhe, është një ftesë për vizitë në Republikën Domenikane. Ftesa, është në emrin tim. Është e personalizuese, por vet mendoj mos me shkue. Është më 15-18 dhjetorë. Pjesërisht, është e pagueme. Pas shqyrtimit, miratohet ftesa që: Kreshnik Radoniqi dhe Alban Krasniqi të udhëtojnë për një konferencë në Republikën Domenikane.

7. Të ndryshme !